

REPUBLICA E SHQIPËRISË  
BASHKIA FUSHË-ARRËZ  
KËSHILLI

Nr.4076 Prot

Fushë-Arrëz më, 25/10/2024

P/VENDIM

Nr.31 datë 25.10.2024

**“PËR  
DHËNIE E DAKORDËSISË PËR DHËNIE NË PËRDORIM TË NJË SIPËRFAQJE  
PYJORE PUBLIKE PREJ 0.0719 HA PËR; KANALIN E LINJES SË UJIT NË  
TERRITORIN E BASHKISË FUSHË-ARRËZ PËR SHOQERINË “UJI PUKA” SH.P.K  
NË ZONEN KADRATALE ME NR.1657 DHE NR.2686, NË TERRITORIN  
ADMINISTRATIV TË BASHKISË FUSHË-ARRËZ”**

Bazuar në Ligjin nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, neni 54, pika e ; Ligjin nr.57/2020 “Për Pyjet” ; VKM-në nr.134 date 3.3.2021 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.433 datë 08.06.2016 të këshillit të ministrave “Për transferimin në pronësi të Bashkive të pyjeve dhe të kullotave publike sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish Komunave/Bashkive” ; VKM-në nr.559 datë 29.07.2022 “Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënie në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar për veprimtari ekonomike, si dhe prodhimet drusore dhe jo drusore pyjore” ; Udhezimi nr.1 datë 09.06.2016 “Për rregullat, procedurat e kërkimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullor publik”, si dhe referuar raportit tekniko-ekonomik të hartuar nga Specialistat e Drejtorisë Administrimit të Pyjeve dhe Kullotave pas depozitimit të dosjes teknike me dokumentacionin sipas Udhezimi nr.1 datë 09.06.2016;


- I propozojmë Këshillit Bashkiak Fushë-Arrëz; Dhënie e dakordesinë për dhënie në përdorim të një sipërfaqje pyjore publike prej 0.0719 ha për; Kanal in e linjes së ujit në territorin e Bashkisë Fushë-Arrëz për Shoqerinë “UJI PUKA” Sh.p.k në zonen kadastrale me nr.1657 dhe nr.2686 në territorin administrative të Bashkise Fushë-Arrëz.
- Pas miratimit të dakordesisë nga Këshilli Bashkiak Fushë-Arrëz Sektori Juridik dhe Drejtoria e Administrimit të Pyjeve dhe Kullotave do të vazhdojnë procedurat për lidhjen e kontrates së qerasë me subjektin.
- Bashkëlidhur këtij Projekt – Vendimi është relacioni shprehues dhe lista e ngastrave/nëngastrave pyjore që kalon gjurma e kanalit të ujit në territorin administrative të bashkisë Fushë-Arrëz.

**RI I ADM PYJEVE DHE KULLOTAVE**

**Ardmir Doda**



**JURISTI**  
**Redona Hasani**



**KRYETARI**

**Hil Curri**



---

**KRYETARI I KESHILLIT**

**Nikolin Bardhoku**